



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datat **28.05.2024**, Nr. Regj. Them. 320 dhe **30.05.2024**, Nr. Akti 313 janë paraqitur 2 kërkesa penale nga personat nën hetim **Redi Molla** dhe **Mariglen Qato**, kërkesa me të njëjtin objekt: zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”.
2. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **12.06.2024 Nr. Akti 352**, ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën me objekt: Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar ndaj personit nën hetim **Taulant Tusha**, lidhur me procedimin penal nr. 75 të vitit 2023.
3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me një vendim të vetëm vendosi: Bashkimin e kërkesave penale, si një kërkesë e vetme. Në përfundim të gjykimit, Gjykata **bazuar në nenin 112, 260, 246, pika 6, 338, të K.Pr.Penale dhe Vendimin Unifikues Nr .7 datë 14.10.2014** me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Rudina Palloj, me vendimin Nr. 352, datë 24.06.2024, vendosi:
 1. Rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim **Redi Molla** për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, si të pabazuar në ligj.
 2. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar ndaj personit nën hetim **Redi Molla**, me Vendimin nr.28, datë 28.03.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr. 18, datë 30.05.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
 3. Rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim **Mariglen Qato** për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, si të pabazuar në ligj.
 4. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar ndaj personit nën hetim **Mariglen Qato**, me Vendimin nr.28, datë 28.03.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr. 18, datë 30.05.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
 5. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar ndaj personit nën hetim **Taulant Tusha**, me Vendimin nr.28, datë 28.03.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr.

18, datë 30.05.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmbja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë më datë 24.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar